

Nisma për zhvillimin e vazhdueshëm profesional i mësuesve dhe instruktorëve të AFP-së

Lista e aktiviteteve 2019

Nr.	Trajnimi	Kategoria	Periudha	Pjesëmarrësit	Informacion për trajnimin
1	Printerë 3D	Teknologji dhe ofertë e re (profil i ri)	Shkurt 2019	29 mësues dhe nxënës të drejtimeve TIK & elektronikë të shkollës “Gjergj Canco” në Tiranë	Pas instalimit të printerëve dhe skanerëve 3D në shkollë, mësuesit dhe nxënësit e përzgjedhur u trajnuan për përdorimin e pajisjeve dhe programeve për modelimin, si bazë për të nxënëit ndërdisiplinor të bazuar në projekte, i cili synon rritjen e aftësive dhe krijimtarisë së nxënësve dhe punës në grup.
2	Smart Home (Shtëpia Inteligjente)	Teknologji dhe ofertë e re (profil i ri)	Mars 2019	11 mësues të shkollës “Gjergj Canco” në Tiranë	Përmes një programi trajnimi dhe udhëzimi në praktikë të ofruar nga ekspertë të industrisë, pajisjet e laboratorit Shtëpia Inteligjente u instaluan në bashkëpunim me stafin e shkollës. Laboratori Shtëpia Inteligjente së bashku me laboratorin e Automjeteve Elektrike janë pjesë e strategjisë së S4J për të prezantuar teknologji të reja në AFP dhe për modernizimin e ofertës së AFP-së.
3	Trajnim dhe Certifikim për Sigurinë	Trajnim mbështetës	Mars 2019	30 pjesëmarrës (10 mësues dhe 20 nxënës nga drejtimi elektroteknikë), shkolla industriale “Pavarësia” në Vlorë	Trajnimi ofroi njohuri për sigurinë në punë për mësuesit dhe instruktorët që përballen direkt me rreziqe në bazën prodhuese. Pjesëmarrësit u përgatitën për certifikim dhe provimi u organizua në vendin e punës. Nxënësve të shkollës u kërkohet të kenë këtë certifikim para se të fillojnë praktikën profesionale në OSHEE. Mësuesit do t’i përfshijnë njohuritë e përditësuara në planet e tyre mësimore dhe do të ofrojnë vetë këtë trajnim në vitet e ardhshme akademike.

4	Automjetet elektrike	Teknologji dhe ofertë e re (profil dhe modul i ri)	Mars deri prill 2019	14 pjesëmarrës, shkolla industriale "Pavarësia" në Vlorë dhe bizneset partnere	Një Trajnim i Trajnerëve (ToT) sipas standardeve të industrisë u ofrua në laboratorin e ri për Automjetet Elektrike në shkollën industriale "Pavarësia" në Vlorë. ToT do të integrohet si një modul me zgjedhje në kurrikulat kombëtare dhe do të ofrohet gjithashtu si një kurs afatshkurtër. Laboratori i Automjeteve Elektrike së bashku me laboratorin Shtëpia Inteligjente janë pjesë e strategjisë së S4J për të prezantuar teknologji të reja në AFP dhe për modernizimin e ofertës së AFP-së.
5	Këshilli i Sigurisë	Trajnim mbështetës	Prill 2019	Drejtuesi i shkollës, anëtarët e Këshillit të Sigurisë së krijuar, shkolla industriale "Pavarësia" në Vlorë	Në zbatim të ligjit dhe rregulloreve në Shqipëri, një nga hapat më të rëndësishëm është krijimi dhe organizimi i Këshillit të Sigurisë së Shkollës
6	Industria e Sigurimeve	Ofertë e re (profil i ri)	Prill 2019	16 mësues, shkolla Ekonomike Tiranë, shkolla Tregtare Vlorë, shkolla "Kolin Gjoka" Lezhë dhe shkolla "Kristo Isak" Berat	Mësuesit u trajnuan nga ekspertë të industrisë në Sigurime në mënyrë që të përgatiten më mirë për të ofruar këtë profil vitin e ardhshëm akademik. Materialet e trajnimit përfshirë shembuj praktikë u ofruan si pjesë e këtij trajnimi të mbështetur nga Shoqata Shqiptare e Siguruesve.
7	HVAC	Trajnim mbështetës	Prill 2019	16 mësues, shkolla industriale "Pavarësia" në Vlorë	Trajnimi u ofroi mësuesve njohuri të thella, aftësi dhe materiale të përditësuara në lidhje me bazat e HVAC (Ngrohja, Ventilimi dhe Kondicionimi) dhe sistemet e mbrojtjes nga zjarri, të cilat ata do t'i integrojnë në programet e tyre mësimore.

8	Platforma e të Nxënit Virtual (MësoVET)	Sisteme dhe platforma	Prill 2019	31 mësues (Vlora, Shkodra, Lezha dhe Tirana) u trajnuan për përdorimin e platformës, si dhe u angazhuan me përditësimin dhe përdorimin e saj.	Mesovet.al është një platformë mësimore virtuale e krijuar me mbështetjen e projektit S4J për një përvojë të zgjeruar të mësimdhënies dhe mësim nxënies për ofruesit e AFP-së. Platforma mbështet mësuesit me materiale mësimore digjitale dhe materiale trajnimi. Mësuesit u trajnuan të përdorin platformën, të përgatisin dhe të ngarkojnë materiale digjitale, të regjistrojnë studentë në kurse online dhe të nxisin përdorimin në një shkallë më të madhe.
9	Platforma e menaxhimit të QFP-së (IMPRO)	Sisteme dhe platforma	Prill 2019	Përfaqësues nga QFP në Vlorë, SHKP, QFP #4 në Tiranë	IMPRO është një Sistem për Menaxhimin e Informacionit i krijuar me mbështetjen e S4J për menaxhim më të mirë të institucioneve ofruese të AFP-së. Në bashkëpunim me SHKP-në, tani platforma është aktive edhe për Qendrat e Formimit Profesional (jo vetëm për shkollat). Përfaqësuesit u trajnuan për të përdorur platformën dhe funksionet e saj.
10	Guida Turistike	Ofertë e re (profil i ri)	Maj 2019	13 mësues, shkolla "Hamdi Bushati" Shkodër, shkolla Tregtare Vlorë, shkolla "Kolin Gjoka" Lezhë dhe shkolla "Kristo Isak" Berat	Trajnim teorik dhe praktik i ofruar nga ekspertë të industrisë në guidat turistike, së bashku me materialet e trajnimit.
11	Video Pedagogjia	Trajnim mbështetës	Shtator 2019	8 mësues, shkolla "Hamdi Bushati" Shkodër, shkolla "Kolin Gjoka" Lezhë, shkolla "Gjergj Canco" Tiranë, shkolla industriale "Pavarësia"	Video pedagogjia e koncepton videon një instrument në procesin e mësimdhënies dhe nxënies (skenari pedagogjik), dhe jo një si zëvendësues të këtij procesi. Video pedagogjia përdoret në shumë nivele arsimore, si pjesë e të nxënit formal, informal dhe joformal, qoftë profesional

				<p>Vlorë, dhe shkolla “Kristo Isak” Berat</p>	<p>apo akademik, fillestar apo i vazhduar, përmes punës, i vetë-organizuar ose në klasë.</p> <p>Si pjesë e strategjisë së S4J për modernizimin e procesit mësimor, pjesëmarrësit u njohën me mënyrat praktike se si mund të krijojnë dhe integrojnë video dhe teknologji në orën e mësimi.</p>
--	--	--	--	---	--